

© 2023 ZENELAJ, E; HAWA, A; BEQIRI, K; DURMISHI, E. & Buletini Shkencor Reald.

This is an open access article licensed under the [Creative Commons Attribution 4.0 International License](https://creativecommons.org/licenses/by/4.0/)

Peer review method: Blind review

Review Article - case study

DOI: 10.59858/BSHR100052

Received:01.11.2023, Accepted: 06.12.2023, Published: 15.12.2023


**Cito:** Zenelaj, E; Hawa, S;Beqiri, K; (2023) (2023) “Indeksimi ne CROSS REFF, integritet, zhvillim institucional dhe professional’, *Buletini Shkencor Reald* ,Vol 8(2), pp.34–45. 10.59858/BSHR100052


## INDEKSIMI NE CROSS REFF, INTEGRITET, ZHVILLIM INSTITUCIONAL DHE PROFESSIONAL

**Dr. Engjëllushe ZENELAJ<sup>1</sup>, Dokt.Suada HAWA<sup>2</sup>, Dr. Ermelinda DURMISHI<sup>3</sup>, Ing. Kevin BEQIRI<sup>4</sup>**

<sup>1</sup>Kolegji Universitar Reald, Vlorë, Albania  <https://orcid.org/0000-0002-1653-6534>  [enxhizenelaj@gmail.com](mailto:enxhizenelaj@gmail.com)

<sup>2</sup>Ministria e Arsimit dhe e Sporteve, Albania  <https://orcid.org/0009-0008-1909-1826>  [suadahawa@gmail.com](mailto:suadahawa@gmail.com)

<sup>3</sup>Ministria e Arsimit dhe e Sporteve, Albania,  [ermelinda.durmishi@arsimi.gov.al](mailto:ermelinda.durmishi@arsimi.gov.al)

<sup>4</sup>Kolegji Universitar Reald, Vlorë, Albania  [kevin.beqiri@unireald.edu.al](mailto:kevin.beqiri@unireald.edu.al)

### **Abstrakt**

*Cross-Ref është një platformë e njohur ndërkombëtare për indeksimin e botimeve shkencore. Ky artikull analizon rolin dhe rëndësinë e indeksimit në Cross-Ref për revistat shkencore dhe si ky proces ndikon në integritetin e kërkimeve shkencore, zhvillimin institucional dhe individual. Në këtë artikull, është bërë një analizë e thellë e efekteve të indeksimit në Cross-Ref në revistat shkencore, duke përfshirë rritjen e vizibilitetit të tyre, si dhe ndikimin në kualitetin e kërkimeve dhe citimet e autorëve. Po ashtu, është shqyrtuar se si indeksimi në Cross-Ref mund të ndikojë në financimin dhe zhvillimin institucional të institucioneve akademike dhe hulumtuese, duke rritur reputacionin e tyre dhe arritjet shkencore.*

*Përmes një analize empirike të procesit të indeksimit të revistës shkencore Buletini Shkencor Reald, e cila është botim i Kolegjit Universitar*

---

*Reald janë identifikuar avantazhet dhe sfidat e indeksimit në Cross-Ref për autorët e individëve, institucionet e tyre dhe revistat shkencore. Në fund të artikullit, paraqiten përfunime dhe rekomandime për autorët, redaktorët e revistave dhe institucionet për të përfutuar maksimalisht nga ky proces dhe për të ruajtur integritetin e kërkimit shkencor në një mjedis të ndryshëm shkencor.*

*Ky artikull ofron një perspektivë të thellë dhe reale mbi rolin e indeksimit në Cross-Ref dhe efektet e tij në botën e kërkimit shkencor dhe institucioneve akademike, duke nxitur një diskutim më të gjerë për temën në fushën e studimeve shkencore*

***Fjalë kyçe:**, indeksim cross ref, revista shkencore, integritet, zhvillim,*

## **I. HYRJE**

Në këtë epokë të informacionit dhe të komunikimit intensiv dhe voluminoz nga disa burime, është shtuar sfida e kërkuesve dhe e institucioneve në qendër të të cilave janë publikimet shkencore. Në këto rrethana indeksimi i revistave shkencore është bërë një aspekt i rëndësishëm i kërkimeve akademike dhe i zhvillimit të institucioneve arsimore dhe hulumtuese. Në këtë kontekst, Cross-Ref, një platformë ndërkombëtare për indeksimin e literaturës shkencore dhe udhëzimit të citimeve, luan një rol të rëndësishëm. Ky artikull ka për qëllim të hedhë dritë mbi rolin dhe ndikimin e indeksimit në Cross-Ref në integritetin e kërkimeve shkencore, zhvillimin institucional dhe suksesin individual të autorëve.

Qëllimi kryesor i këtij studimi, duke marrë në konsideratë rastin e revistës “Buletini Shkencor Reald” është të shpjegojë se si indeksimi i revistave shkencore në Cross-Ref ndikon në shumë aspekte të botës shkencore dhe akademike. Përmes një analize të thellë, synohet të zbulohen avantazhet dhe sfidat e këtij procesi për autorët, redaktorët e revistave dhe institucionet arsimore. Kjo analizë do të ndihmojë në kuptimin e mënyrës se si kërkimet shkencore janë të vlerësuara, promovuar dhe shfrytëzuar në një mjedis ku konkurrenca është e rritur.

Për të arritur qëllimin e këtij studimi, janë përcaktuar disa objektiva kryesore:

- Shqyrtimi i efekteve të indeksimit në Cross-Ref në rritjen e vizibilitetit të revistave shkencore dhe ndikimin e tyre në kërkimin shkencor.
- Analizimi i mënyrës se si indeksimi në Cross-Ref ndikon në kualitetin e kërkimeve shkencore dhe citimet e autorëve, duke përfshirë rritjen e impakt faktorit dhe shpërndarjen e informacionit.

- Shqyrtimi se si indeksimi në Cross-Ref mund të ndikojë në financimin dhe zhvillimin institucional të institucioneve akademike dhe hulumtuese, duke rritur reputacionin e tyre dhe arritjet shkencore.

Në fund, ky artikull do të ofrojë një analizë të gjithanshme të temës dhe do të prezantojë rekomandime për autorët, redaktorët e revistave dhe institucionet akademike për të përfutur maksimalisht nga ky proces dhe për të ruajtur integritetin e kërkimit shkencor në një mjedis të ndryshëm shkencor.

Ky studim synon të ndihmojë në thellimin e diskutimit në lidhje me indeksimin në Cross-Ref dhe ndikimin e tij në botën e kërkimit shkencor, duke ofruar një perspektivë të pasur dhe analitike për lexuesit dhe përdoruesit e kësaj platforme të rëndësishme të kërkimit shkencor.

## II. METODOLOGJIA

Për të arritur objektivat e studimit tonë dhe për të adresuar pyetjet e kërkimit, kemi ndjekur një metodologji të hollësishme që përfshinë hulumtimin bibliografik, analizën e të dhënave dhe intervistat me profesionistë të fushës. Këto metoda janë përdorur në tandem për të siguruar një analizë të plotë dhe objektive të ndikimit të indeksimit në Cross-Ref.

Për të kuptuar historinë dhe zhvillimin e indeksimit në Cross-Ref dhe rolin e tij në botën e kërkimit shkencor, është filluar me një hulumtim bibliografik të gjerë. Ky proces përfshiu shqyrtimin e literatureve shkencore, raporteve, dhe dokumenteve të lidhura me temën duke përdorur baza të të dhënave të njohura akademike. Gjithashtu indicia fillestare për këtë studim dhe iniciativë ishte edhe Urdhri i Ministrisë së Arsimit në Shqipëri i datës 27 Janar 2023, e cila do të bëj regjistrimin dhe renditjen e revistave shkencore dhe një ndër kriteret ishte edhe indeksimi në Crossref dhe pajisja me kodin DOI.

Për të vlerësuar efektet e indeksimit në Cross-Ref në rritjen e vizibilitetit të revistave shkencore dhe citimet e autorëve, si dhe bazuar në të të dhënave historike të indeksimit të revistave dhe të dhënat për citimet për to krahasuar para dhe pas indeksimit në Cross-Ref është bërë analizimi i e rezultateve pas indeksimit të revistës sonë Buletini Shkencor Reald, duke evidentuar ndryshimin për ecurinë e revistës.

Për të përshkruar ndikimin e indeksimit në Cross-Ref në financimin dhe zhvillimin institucional të institucioneve akademike, janë zhvilluar pyetësorë me stafin akademik dhe admisnitrativ të institucioneve të arsimit të lartë. Pyetësorët janë përdorur për të nxjerrë në pah opinionet dhe perspektivat për indeksimin e botimeve shkencore nga pikëpamja e akademikëve dhe administratorëve të institucionit.

Ky integrim i metodave kualitative dhe kuantitative është përdorur për të marrë një pamje të plotë të ndikimit të indeksimit në Cross-Ref në fushën e kërkimit shkencor dhe institucioneve akademike. Kjo përjasje metodologjike na ka mundësuar të kuptojmë dhe

identifikojmë një gamë të gjerë të perspektivave dhe të sigurojmë një analizë më të detajuar të temës e cila për më tepër do të shërbejë për të rritur më tej cilësinë e performancës së revistës sonë shkencore.

### **III. RASTI I INDEKSIMIT TË BULETINI SHKENCOR REALD DHE INTERPRETIM I GJETJEVE TË PYETËSOREVE NDAJ INSTITUCIONEVE DHE AKADEMIKËVE**

#### **3.1. Profili i revistës shkencore Buletini Shkencor Reald**

Revista shkencore “Buletini Shkencor Reald” është një botim i Kolegjit Universitar Reald, Vlore. Kjo revistë është e pajisur me ISSN elektronike dhe ka filluar të botohet që nga viti 2015. Revista vazhdimisht ka publikuar dy numra në vit, një fushën e shkencave tekniko-mjekësore dhe tjetri në fushën e shkencave sociale dhe ekonomike. Nisur nga strategji institucionale dhe objektivat e zhvillimit të institucionit në kuadër të procesit të akreditimit dhe jo vetëm, si dhe bazuar në Urdher-Nr.36-date-24.1.2023<sup>1</sup> e Ministrisë së Arsimit “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRIJIMIN E REGJISTRIT SHTETËROR TË REVISTAVE SHKENCORE QË BOTOHEN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” stafi i Qendrës së Kërkimit Shkencor u vendos përball objektivit të indeksimit të revistës në platformat e ndryshme me qëllim rritjen e performancës dhe marrjen e një vlerësimi sa më të mirë.

Gjatë hulumtimit nëpër databaza të ndryshme arritëm në konkluzionin se fillesa duhej të ishte nga indeksimi në crossref dhe epajisja me codin DOI, pastaj dyert për revistënishin të hapura në shumë platforma të tjera. I gjithë procesi ishte shumë orientues dhe bashkëpunues nga stafi i Crossref, sepse ne duke qenë pa përvojë në këtë fushë vazhdimisht patëm asistencën e tyre. Procesi i indeksimit në cross ref duket ikoplikuar nga jashtë kur shikon por orientimi hap pas hapi për plotësimin ekritereve që të vjen nga stafi i Cross Ref është si busull orientimi për të menaxhuar procesin. Sot Buletini Shkencor Reald është i indeksuar në Crossref, I pajisur me Kodin DOI si revistë, kodin DOI për secilin volum, dhe kodin DOI për cdo artikull.

#### **a. Rezultatet aktuale të menjëhershme pas Indeksimit në Crossref të Buletini Shkencor Reald**

Pas indeksimit në Crossref, revista jonë u bë e dukshme edhe në platforma të tjera.

- Së pari, në platformën researchgate u krijua automatikisht profile nga indeksimi në Crossref.

---

<sup>1</sup> <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2023/01/Urdher-Nr.36-date-24.1.2023-Pdf.pdf>

- Së dyti, revista mori një vlerësim shumë të mirë edhe në platformën COPERNICUS për vitin 2022.
- Së treti, Pas indeksimin në Crossref, është regjistruar në Web of sciences dhe pritet vlerësimi i tyre.
- Së katërti, është në porces për në DOAJ.
- Së pesti, në platformën academia.edu pas pajisjes me DOI artikujt janë më të dukshëm.

Të gjitha këto zhvillime janë shumë positive si për institucionin por edhe për stafin akademik i cili ka botuar.

Në aspektin e revistës, rezultuan shumë pozitiv, pasi kemi një rritje të interes për botime në revistën tonë, jo vetëm nga autorë vendas, por edhe të huaj.

### **b. Rezultatet e pyetësorit për stafin akademik**

Pas procesit të indeksimit në Crossref, Qendra e Kërkimit Shkencor zhvilloi një pyetësor me stafin akademik të Kolegjit dhe me akademikë që ne bashkëpunojmë si dhe autorë që kanë botuar në revistën tonë. Qëllimi i këtij pyetësori ishte për të evidentuar nëse ka një lidhje midis integriteti të autorëve dhe botimeve të indeksuara si dhe si është ky raport, pra ku konsiston ai konkretisht. Pyetësorit iu përgjigjën 184 autorë/kërkues/akademikë ne Shqipëri.

**Tabela Nr.1, Pyetësori dhe rezultatet për kërkuesit**

Nr.	Pyetja	Alternativat	Rezultati
1.	<i>A zgjidhni ju për botim revista të cilat janë të indeksuara në platformat të ndryshme?</i>	a. Po b. Jo	a. 126 b. 58
2.	<i>A ndikon në zhvillimin tuaj profesional publikimi në revista të indeksuara?</i>	a. Po b. Jo	a. 162 b. 22
3.	<i>A ka lidhje midis integriteti shkencor të kërkuesit dhe indeksimit të botimeve shkencore në crossref?</i>	a. Po b. Jo	a. Po b. Jo
4.	<i>A vëreni rritje të dukshmërisë së punës suaj për botimet e indeksuara në crossref?</i>	a. Po b. Jo	a. 168 b. Jo
5.	<i>A ndjeni përgjegjësi të shtuar pas indeksimit të botimeve shkencore në crossref?</i>	a. Po b. Jo	a. 104 b. 80
6.	<i>A vëreni nxitje për rritje të kontributit shkencor për të publikuar në revistat e indeksuara në crossref?</i>	a. Po b. Jo	a. 135 b. 49
7.	<i>Cilin aspekt pozitive për publikimin e artikujve në revistat e indeksuara do të perzgjidhni si me te rendesishem?</i>	a. Rritjen e Integritetit Shkencor b. Rritja e vizibilitetit të punës së kërkuesve c. Mbrojtja e të drejtës së autorit d. Ndikimi në Karrierën e Kërkuesve	a. 38 b. 106 c. 8 d. 32

Në aspektin numerik të gjithë janë përigjur se kanë vërejtur rritje të dukshmërisë së ëpunës për boimet e indeksuara si dhe kanë pasur shumë aspekte pozitive nga botimet e indeksuara. Për akadmeikët përfitimet nga botimet e indeksuara janë në disa dimensione si në aspektin e zhvillimit të profilit të tyre akademik por edhe atë institucional.

**c. Analiza e gjetjeve nga pyetësorët**

Në aspektin e integritetit të kërkuesve shkencor, në saj të pyetësorëve dhe intervistave me stafit akademik dhe autorët konkludohet në mënyrë analitike se indeksimi i botimeve shkencore në Crossref, sjell:

- Rritjen e Integritetit Shkencor:

Indeksimi në Cross-Ref ka një ndikim pozitiv në integritetin e kërkuesve shkencor duke rritur transparencën, gjetjen e burimeve, dhe përcjelljen e citimeve. Autorët janë më të motivuar për të paraqitur punët e tyre në një mënyrë të qartë dhe të saktë, pasi ato do të jenë të disponueshme për një audiencë të gjerë. Kjo kontribuon në përmirësimin e etikës së kërkimit shkencor.

- Rritja e ndërgjegjes dhe vlerave të kërkimit:

Indeksimi në Cross-Ref krijon një sistem të qartë të citimeve dhe referencave, duke ndihmuar në vlerësimin e sinqeritetit dhe validitetit të punës së kërkuesve. Kjo ndihmon në parandalimin e plagjiaturës dhe shpërdorimit të informacionit, duke rritur besueshmërinë e publikimeve shkencore.

- Rritja e vizibilitetit të punës së kërkuesve:

Përmes indeksimit në Cross-Ref, punët shkencore shfaqin një nivel të lartë të vizibilitetit, duke u bërë të qasshme për një audiencë më të madhe kërkuesish. Kjo ndihmon në shpërndarjen e njohurive dhe gjetjen e burimeve në mënyrë më të shpejtë dhe më të lehtë për kërkuesit e tjerë, duke rritur ndikimin dhe vlerën e punës së kërkuesve që publikojnë artikujt.

- Kontributi në Rritjen e Cilësisë së Punës Shkencore:

Indeksimi në Cross-Ref ka një impakt pozitiv në cilësinë e punës shkencore. Kjo ndodh përmes mundësisë të shpërndarjes së informacionit në një platformë të besueshme dhe ndërkombëtare. Kështu, autorët janë të përkushtuar për të prodhuar punë të qëndrueshme dhe cilësore.

- Ndikimi në Karrierën e Kërkuesve:

Për kërkuesit individualë, botimi në revista shkencore të indeksuara në Cross-Ref ndikon në rritjen e reputacionit të tyre, rritjen e mundësive për financim dhe përmirësimin e karrierës. Ky ndikim pozitiv ndihmon kërkuesit të kenë një motivim shtesë për të bërë kërkime më të mira dhe më të thella.

- Përmirësimi i Transparencës së Procesit të Kërkimit:

Indeksi në Cross-Ref promovon transparencën në procesin e kërkimit duke përfshirë regjistrimin e protokolleve të hulumtimit dhe raportimin e detyrave dhe të dhënave. Kjo rrit nivelin e transparencës dhe përgjegjshmërisë në botën e kërkimit shkencor.

- Mbrojtja e të drejtës së autorit

Publikimi në botime të indeksuara sipas akademikëve sjell një mbrojtje të punës së tyre, duke siguruar kështu mbrojtjen e të drejtës së autorit.

#### **d. Rezultateve e pyetësorëve për administratorët e institucioneve të arsimit të lartë**

Një aspekt i rëndësishëm gjatë këtij hulumtimi ishte edhe marrja e opinionit të stafit administrativ të cilët kujdesen për mbarvajtjen dhe performancën totale sidomos financiare.

Bazuar në faktin që Kolegji Universitar Reald operon si institucion i arsimit të lartë jopublik, por edhe duke njohur rëndësinë e performancës së kërkimit shkencor për të ardhmen e institucionit si dhe për aspektin financiar, ky hulumtim u fokusua edhe tek bordet e administrimit dhe administratorët e institucioneve të arsimit të lartë.

Nga intervistat me stafin administrativ, drejtuesit, anëtarë të Njesisë së Sigurimit të Cilësisë si brenda institucionit tonë si dhe institucioneve të tjera që bashkëpunojmë rezultojnë se indeksi I botimeve shkencore në Cross-Ref ka një rëndësi të madhe për zhvillimin e institucioneve akademike.

Pyetësorit i janë përgjigjur 38 persona në pozicione si administratorë, anëtarë të Njesisë së Sigurimit të Cilësisë, Drejtues të strategjisë, anëtarë të Bordit të Administrimit etj.

Botimet shkencore cilësohen si të rëndësishme për ecurinë e institucionit. Shumica e tyre gjithashtu cilësojnë si të rëndësishme indeksimin e botimeve shkencore periodike. Megjithatë vërehet se në disa raste ka hezitim në aspektin financiar për indeksimin e botimeve shkencore periodike. Përmirësimi i reputacionit është përfundim i parë i cilësuar nga të anketuarit nga botimet shkencore të indeksuara, ndërsa më pas renditet rritja e audiencës dhe kapaciteteve shkencore si dhe rritja e ndërkombëtarizimit.

**Tabela Nr. Pyetësi për administratorët/postet administrative dhe rezultati**

Nr.	Pyetja	Alternativat	Rezultati
1.	<i>A i konsideroni botimet shkencore të rëndësishme për ecurinë e institucionit tuaj?</i>	a. Po b. Jo	a. 30 b. 8
2.	<i>A ka rëndësi për ju indeksimi i botimeve shkencore?</i>	a. Po b. Jo	a. 22 b. 16
3.	<i>A i mbështesni iniciativat akademike për indeksimin e botimeve shkencore?</i>	a. Po b. Jo	a. 20 b. 18
4.	<i>A hezitoni në aspektin financiar për të paguar faturat për indeksimin e botimeve shkencore?</i>	a. Po b. Jo	a. 16 b. 22
5.	<i>A jeni në gjendje të evidentoni një lidhje midis botimeve të indeksuara dhe performancës së institucionit?</i>	a. Po b. Jo	a. 21 b. 17
6.	<i>A mund të identifikoni cilat janë përfitime nga indeksimi i botimeve shkencore për ecurinë e institucionit tuaj?(zgjidhni deri në dy alternativa)</i>	a. Përmirësimi i reputacionit b. Financimi c. Rritja e ndërkombëtarizimit d. Ndikimi në rritjen e kapaciteteve shkencore e. Rritja e audiencës akademike	a. 38 b. 5 c. 10 d. 11 e. 12

#### **e. Analiza e gjetjeve nga pyetësit për administratorët/postet administrative**

Më poshtë po paraqesim analizën e përmeldhur të disa prej gjetjeve më të rëndësishme mbi këtë temë mbi përfitimet institucionale nga indeksimi i botimeve shkencore periodike.

- Përmirësimi i reputacionit dhe shtimit të përgjegjësisë:

Indeksimi në Cross-Ref rrit reputacionin e institucioneve akademike duke i paraqitur ata si qendra të rëndësishme të kërkimit shkencor dhe kontribuuese të njohurive të përgjithshme. Kjo rrit përgjegjësinë dhe kujdesin që institucionet kanë ndaj cilësisë së punës së tyre dhe kontributit të tyre në shoqëri.

- Financimi dhe burimet:

Indeksimi në Cross-Ref ka një ndikim pozitiv në financimin e institucioneve akademike. Institucionet që kanë një histori të suksesit në publikime shkencore kanë tendencë të jenë më të atraktive për burime të ndryshme financimi, duke përfshirë donacionet, grante, dhe kontratat e hulumtimit. Ky financim shton mundësitë për zhvillim dhe rritje. Për institucione të vogla të arsimit të lartë të cilat synojnë zgjerimin e veprimtarisë dhe së tyre ky proces shikohet si përfitues në afatgjatë.

- Rritja e audiencës akademike:



Përmes indeksimit në Cross-Ref, institucionet akademike bëhen të qasshme për një audiencë më të gjerë ndërkombëtare. Kjo rrit ekspozimin dhe arritjen e tyre, duke përmirësuar mënyrën se si institucionet komunikojnë punën dhe kontributet e tyre në botën e shkencës, dhe kjo në këndvështrimin e admistratorëve/investitorëve sjell qëndrueshmëri edhe për ta sudimos për institucionet që operojnë si jopublikë.

- Nxitja e përpjekjeve për kërkim dhe zhvillim:

Një sistem i efektshëm i indeksimit në Cross-Ref inkurajon institucionet akademike të investojnë më shumë në kërkim dhe zhvillim. Për të qëndruar konkurrues në fushën shkencore, institucionet janë të detyruara të promovojnë një mjedis të stimulueshëm për hulumtuesit dhe të investojnë në infrastrukturën e tyre shkencore. Ky aspekt nuk duhet i stepi institucionet pasi ky mbetet esencial për përballimin e konkurrencës.

- Rritja e ndërkombëtarizimit:

Indeksi në Cross-Ref mund të ndihmojë në tërheqjen e studentëve dhe hulumtuesve ndërkombëtarë. Institucionet e indeksuara në Cross-Ref janë më tërheqëse për studentët dhe hulumtuesit e huaj dhe janë më të gatshme për të ndërtuar partneritete dhe bashkëpunime me institucione të tjera të njohura në nivel ndërkombëtar.

- Ndikimi në rritjen e kapaciteteve shkencore:

Indeksi në Cross-Ref ndihmon në rritjen e kapaciteteve shkencore të institucioneve. Kjo përmirëson infrastrukturën e kërkimit, mundëson qasjen në burime të mëdha të literaturës shkencore, dhe përmirëson aftësinë e institucioneve për të ofruar programe të cilësisë të lartë të mësimdhënies dhe hulumtimit.

Konstatohet një rritje e vëmendjes së administratorëve ndaj indeksimit të botimeve shkencore. Administratorët e konsiderojnë si element për të rritur imazhin e institucionit të tyre si dhe për të rritur performancën si dhe rritjen e shanceve për përfitimin e financimeve

#### **IV. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME**

Në përgjithësi indeksimi i botimeve shkencore në Cross ref është ende i panjohur. Buletini Shkencor Reald është botim periodik i një insitucioni të lartë arismor i cili ka realizuar procesin e indeksimit në Crossref.

Indeksi në Crossref ndihmon në përmirësimin e resurseve dhe kapaciteteve shkencore të institucionit. Ky faktor rrit aftësinë e institucionit për të ofruar programe të cilësisë së lartë të mësimdhënies dhe hulumtimit.

Në përfundim, indeksimi në Crossref ka një ndikim thelbësor në integritetin e kërkuesve shkencor, duke promovuar sinqeritetin, transparencën dhe cilësinë e punës së tyre. Ky proces ka avantazhe të konsiderueshme për autorët, institucionet akademike dhe komunitetin shkencor në përgjithësi, duke përmirësuar mënyrën se si kërkimi shkencor është bërë dhe ekuacionin e integritetit të tij.

Indeksimi në Cross-Ref është një komponent kyç për zhvillimin e institucioneve akademike. Ky proces ka potencialin për të rritur reputacionin, të sigurojë burime financimi të mtejshme, dhe të nxitë përmirësimin e kapaciteteve shkencore të institucioneve. Institucionet akademike që i kushtojnë vëmendje të mjaftueshme indeksimit në Cross-Ref kanë mundësi të mëdha për të arritur sukses në kërkim, mësimdhënie dhe zhvillim institucional.

Indeksimi në Crossref ndihmon në përmirësimin e mundësive për financim. Institucionet akademike të indeksuara janë më tërheqëse për burime financimi të ndryshme, duke përfshirë donacione, grante dhe kontrata hulumtimi. Ky financim shton mundësitë për zhvillim dhe rritje.

Për stafin akademik, indeksimi në Cross-Ref ka një ndikim thelbësor në zhvillimin e karrierës dhe ndikimin e tyre në botën e kërkimit shkencor. Ky proces inkurajon cilësinë, përgjegjësinë dhe aftësinë për të kontribuar në njohurinë shkencore në mënyrë të rëndësishme.

Institucionet akademike të indeksuara në Crossref janë më tërheqëse për stafin akademik dhe studentët. Ky faktor ndihmon në rritjen e nivelit të konkurrencës së stafit dhe studentëve dhe në rritjen e reputacionit të institucionit.

Nga gjithë procesi i hulumtimit dhe rasti praktik i ndjekur për rritjen e performacës së botimeve shkencore rekomandohet për cilido se nëse do të fillojë indeksimin e revistës në platformat e njohura, të nisi fillimisht nga indeksimi në Crossref, pasi në këtë mënyrë do të rrisë më shpejt performancës edhe si shkak i lehtësirave që të ofron platforma.

## REFERENCA

1. Buletini Shkencor Reald, “REGULATIONS FOR THE ORGANIZATION AND OPERATION OF THE BULETINI SHKENCOR REALD & MANUSCRIPT SUBMISSION GUIDELINES” 2022, [https://unireald.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Author\\_guidlines\\_Buletini\\_Reald.pdf](https://unireald.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Author_guidlines_Buletini_Reald.pdf)
2. KOLEGJI UNIVERSITAR “REALD” STRATEGJI ZHVILLIMI (2021 – 2026), (Miratuar me Vendim nr. 6, datë 02.06.2020, të Bordit të Administrimit), <https://unireald.edu.al/wp-content/uploads/2022/08/3.-Stratgjia-e-Zhvillimit-Institucional-2021-2026-1.pdf>
3. Urdher-Nr.36-date-24.1.2023 e Ministrisë së Arsimit “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRIJIMIN E REGJISTRIT SHTETËROR TË REVISTAVE SHKENCORE QË BOTOHEN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2023/01/Urdher-Nr.36-date-24.1.2023-Pdf.pdf>

4. LIGJ Nr. 35/2016 “PËR TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E TJERA TË LIDHURA ME TO”

5. Direktivën 2006/116/KE, të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 12 dhjetor 2006, “Mbi afatin e mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe disa të drejtave të lidhura” e amenduar”, Celex: 32006L0116; Fletorja Zyrtare e BE-së, L 372, datë 27.12.2006

6. Direktivën 2004/48/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 29 prill 2004, “Mbi zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale”, Celex: 32004L0048; Fletorja Zyrtare e BE-së, L 157, datë 30.4.2004

7. Direktivën 2001/29/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 22 maj 2001, “Mbi harmonizimin e disa aspekteve të të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të në shoqërinë e informacionit”, Celex: 32001L0029, Fletorja Zyrtare e BE-së, L 167, datë 22.6.2001.

8. Direktivën 2001/84/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 27 shtator 2001, “Mbi të drejtën e rishitjes në dobi të autorit të një vepre origjinale të artit”, Celex: 32001L0084, Fletorja Zyrtare e BE-së, L 272, datë 13.10.2001

9. Direktivën 96/9/ KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 11 mars 1996, ”Mbi mbrojtjen ligjore të bazave të të dhënave”, Celex: 31996L0009, Fletorja Zyrtare e BE-së, L 77, datë 27.3.1996

10. <https://www.crossref.org/>

11. Direktivën 2009/24/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 23 prill 2009, “Mbi mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike”, Celex: 32009L0024, Fletorja Zyrtare e BE-së, L 111, datë 5.5.2009

12. Direktivën 2006/115/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 12 dhjetor 2006, ”Mbi të drejtën e qirasë dhe të drejtën e kreditimit dhe mbi disa të drejta që lidhen me të drejtën e autorit në fushën e pronësisë intelektuale”, Celex: 32006L0115, Fletorja Zyrtare e BE-së, L 376, datë 27.12.2006.

13. Zenelaj E., “*Challenges of Albanian System Education in Systematic Integration of Technology and Education*”, Global Smart Education Conference 2022 Digital Literacy and Smart Learning Forum, Published in 2023 by Smart Learning Institute of Beijing Normal University, 12th Floor, Block A of JingshiScience and Technology Building, No. 12 Xueyuan South Road, Haidian District, Beijing© Smart Learning Institute of Beijing Normal University 2023 , [http://sli.bnu.edu.cn/en/Download/Promotional/Research\\_Report/2023/0321/2821.html](http://sli.bnu.edu.cn/en/Download/Promotional/Research_Report/2023/0321/2821.html)